



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2019:291466

Datë: 15.08.2023

Numri i dokumentit: 04587443

**C.nr.2104/2019**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, divizioni civil**, me gjyqtarin Baki Shigjeqi dhe bashkëpunëtoren profesionale H.D. duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.H. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson H.S. avokat nga Prizreni, kundër të paditurve K.Gj.K. me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson B.M. nga Prishtina dhe K.P.K. me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson B.M. nga Prishtina, për shkak të kompensimit të dëmit jo material, vlera e kontestit 10,000.00 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor - publik, në prani të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse me datë 26.07.2023 mori, këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET** kërkesëpadia e paditësit B.H. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të *“DETYROHEN të paditurit K.Gj.K. me seli në Prishtinë dhe K.P.K. me seli në Prishtinë, që paditësit B.H. nga Prizreni, në emër të dëmit të shkaktuar jomaterial, cenimit të prestigjit, nderit dhe autoritetit dhe personalitetit për periudhën kohore nga datë 19.07.2017 deri me 28.05.2018, për shkak të ndjekjes penale pa bazë ligjore të vërtetuar me aktgjykim lirues, t’ia paguaj solidarisht nga ½ e dëmit të shkaktuar në para dhe atë: për dhembje shpirtërore shumë prej 5.000 (pesëmijë) € dhe për shkelje të prestigjit shumë prej 5.000 (pesëmijë) €, gjithsej 10.000 (dhjetëmijë) €, me kamatë ligjore prej 8 %, nga dita e parashtrimit të padisë, e deri në pagesën definitive, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm”*, **në tërësi e pabazuar**.

**II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësi B.H. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij avokat H.S. nga Prizreni, me datën 17.12.2019, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar padi, të cilën e ka precizuar me parashtrësën e datës 29.03.2023, kundër të paditurve K.Gj.K. dhe K.P.K. të dy me seli në Prishtinë, për kompensimin e dëmit jo material, vlera e kontestit 10,000.00 €.

*1. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse*

Në padinë e paraqitur dhe precizimin e padisë, i autorizuari i paditësit ka theksuar se në bazë të Aktakuzës së të paditurit të rendit të dytë K.P.K. përmes P.Th.P. janë filluar hetimet kundër paditësit me aktvendimin për fillimin e hetimeve PP/I.nr.86/17, datë 19.07.2017, pas të cilës është ngritur aktakuza PP/I.nr.86/17, datë 31.08.2017, me të cilën pa bazë ligjore është akuzuar paditësi B.H. për kryerjen e veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar dhe me këtë e ka dëmtuar rënd paditësin, pasi që me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.89/17, të datës 26.02.2018, paditësi në cilësinë e të akuzuarit është liruar nga akuza, ndërsa me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës DKR në Prishtinë PAKR.nr.223/2018, datë 06.09.2018, është refuzuar ankesa e Prokurorisë Themelore, ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren. Tutje ka shtuar se për periudhën kohore nga ngritja e hetimeve datë 19.07.2017, ngritja e aktakuzës me datë 31.08.2017 nga i padituri i dytë Këshilli Prokurorial i Kosovës, e deri në marrjen e aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.89/17, me datë 06.09.2017, paditësi ka pësuar dëme jo materiale. Andaj gjykatës i ka propozuar që të merr vendim dhe kërkesëpadinë e paditësit ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

E autorizuar e paditësit edhe gjatë shqyrtimeve gjyqësore, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë kërkesëpadisë dhe precizimit të bërë, ndërsa në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim në seancën e datës 26.07.2023, e autorizuar e paditësit ka deklaruar se me administrimin e provave në shqyrtimin kryesor e veçanërisht të Vendimeve të Gjykatave kompetente në këtë drejtim të cilët u administruan si prova, si dhe provave tjera u provua se paditësi B.H. gjatë periudhës së ndjekjes penale nga Policia e Kosovës, të hetimeve të zbatuara në Prokurorinë Themelore Departamenti për Krime të Rënda në Prizren, me ngritjen e Aktakuzës kundër tij nga Prokuroria Themelore Departamenti për Krime të Rënda në Prizren PP/I nr. 86/17, datë 31.8.2017, me publikimin e saj në mjetet e informimit në Kosovë dhe më gjer kundër të pandehurit B.H. tani paditësit, me marrjen e Aktgjykimit lirues të Gjykatës Themelore në Prizren Departamenti për krime të Rënda i formës së prerë Pkr. nr. 89/17, datë 26.02.2018, i plotfuqishëm me Aktgjykimin PAKR nr. 223/18, të datës 06.09.2018, të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë, paditësi B.H. ka përjetua dëme jo materiale, dhimbje shpirtërore, varësisht nga periudha nga hetimet policore e deri tek Aktvendimi përfundimtar i Gjykatës së Apelit të Kosovës, për refuzimin të pa bazuar të Ankesës së Prokurorisë Themelore DKR në Prizren, dhe vërtetimin e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren DKR nr. PKR nr. 89/17 datë 26.02,2018, me të cilin është liruar nga akuza paditësi. Njëkohësisht si rezultat i procedurës penale të përfunduar me Aktvendim e pushimit të procedurës penale kundër të akuzuarit, tani paditësit B.H. në vitin 2018, nga Gjykata e Apelit me të cilin është vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, po ashtu paditësi B.H. ka pësua cenim në të drejtat e personalitetit në formë të cenimit të prestigjit, nderit, autoritetit pasi që i njëjti në këtë periudhë ka qen funksionar i nivelit Komunal në Qeverinë Komunale të Prizrenit të asaj periudhe dhe se në këtë intensiteti i presioni psikologjik ka qenë edhe më i madh ngase nuk ka qen qytetar i rëndomtë e që ka ndikuar në përjetimin e dhembjeve shpirtërore të cilat kanë lënë pasoja të gjata dhe në këtë edhe dëme jomaterial lëndë e çështjes kontestues dhe e kërkesë padisë të paditësit. Në fund gjykatës i ka propozuar që të merr vendim dhe kërkesëpadinë e paditësit ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar si në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim.

E paditura e parë Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me seli në Prishtinë, përmes përgjigjes në padi e ka kontestuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit B.H. nga Prizreni, duke shtuar se bazuar dispozitave të kapitullit XXXVI të Kodit të Procedurës Penale, respektivisht neneve 525 dhe 529, të drejtë kompensimi kanë vetëm personat të cilët me vendim përfundimtar janë shpallur fajtorë ose u është shqiptuar sanksioni penal në formë të prerë, por që më vonë sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik, procedura e rishikuar është pushuar në formë të prerë ose është liruar nga akuza ose akuza është refuzuar. Nga provat të cilat e paditura i posedon, vërehet se i njëjti fare nuk ka qenë i privuar nga liria dhe se vendimin përfundimtar është refuzuar akuza ndaj të njëjtit.

Edhe gjatë shqyrtimeve gjyqësore i autorizuari i të paditurës së parë Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me seli në Prishtinë, ka mbetur në tërësi sikurse në përgjigjen në padi, duke e kontestuar padinë e paditësit, ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se edhe më tej mbetin pranë përgjigjes në padi dhe deklaratimet në seancat e kaluara, duke e kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesë padinë e paditëses si të pa bazuar në raport me KGJK për faktin, se bazuar në shkresat e lëndës shihet se aktakuza është ngritur nga Prokuroria Themelore Departamenti për Krime të Rënda PP/I nr.86/17 Prizren me datë 31.08.2017, ndërsa Gjykata Themelore në Prizren, PKR.nr.89/17, të datës 26.02.2018, ka marrë Aktgjykim ku lirohet nga akuza paditësi, e po ashtu Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda PAKR.nr.223/18, të datës 06.09.2018, e ka refuzuar si të pabazë ankesën e Prokurorisë Themelore – DKR në Prizren, kurse aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, PKR.nr.89/17, të datës 26.02.2018 e ka vërtetuar. Andaj, gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pa bazuar, në raport me KGJK-në.

Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

E paditura e dytë Këshilli Prokurorial i Kosovës, me seli në Prishtinë, e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se Prokurori i Shtetit, në çdo hap të procedurës ka ushtruar autorizimet e parapara ligjore, konform nenit 109 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kodin e Procedurës Penale dhe Ligjin për Prokurorin e Shtetit, si dhe organi i akuzës ndërmerr veprime procedurale në çdo rast apo rrethanë kur ekziston dyshimi i arsyeshëm se është kryer vepra penale. Prokurori i Shtetit, në rastin konkret ka ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore që ka qenë i obliguar ti ndërmerr me qëllim të vërtetimit të kryerjes së veprës penale si dhe kryerësit të kësaj vepre penale. Po ashtu, është me rëndësi të konstatohet se të paditurës në rastin konkret i mungon legjitimiteti i plotë real pasiv për të qenë palë në kontestin lëndor. Në fund gjykatës i ka propozuar që të refuzohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit.

Edhe gjatë shqyrtimeve gjyqësore i autorizuari i të paditurës së dytë Këshilli Prokurorial i Kosovës, me seli në Prishtinë, ka mbetur në tërësi sikurse në përgjigjen në padi, duke e kontestuar padinë e paditësit, ndërsa në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim në shqyrtimin e datës 26.07.2023, ka deklaruar se edhe pas administrimit të provave, mbetin në tërësi pranë përgjigjes në padi, duke e kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë dhe precizimin e padisë së paditësit, duke theksuar se prokurori i shtetit në çdo hap të procedurës ka ushtruar autorizimet, ashtu si parashihen me nenin 109 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Po ashtu ka shtuar se Këshillit Prokurorial

të Kosovës, i mungon legjitimiteti i plotë real pasiv për të qenë palë në procedurë, pasi që në rastin konkret prokurori i shtetit nuk ka ndonjë raport juridiko civil me paditësin, mirëpo i njëjti ka ushtruar detyrat dhe përgjegjësitë e tij të parapara me Kushtetutë. Në fund gjykatës i ka propozuar që të merr vendim dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzojë si të pabazuar.

Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

## 2. Provat e administruara

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: aktvendimin për fillimin e hetimeve me shenjën PP/I.nr.86/17 datë 19.07.2017, lëshuar nga PTH-DKR në Prizren; aktakuzën me shenjën PP/I.nr.86/17 datë 31.08.2017, lëshuar nga PTH-DKR në Prizren; aktgjykimin penale me shenjën PKR.nr.89/17 i datës 26.02.2018 lëshuar nga Gjykata Themelore në Prizren-departamenti për Krime të Rënda; aktgjykimin penale me shenjën PAKR.nr.223/18 i datës 06.09.2018 lëshuar nga Gjykata e Apelit në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda; kërkesën e të autorizuarit të paditësit drejtuar KGJK të Kosovës – komisionit për kompensimin e dëmit të personave të privuar pa bazë nga liria, i datës 27.07.2019; aktvendimin me nr. të protokollit 09/136 i datës 11.11.2019, lëshuar nga KGJK-komisioni për kompensimin e dëmit të personave të dënuar pa arsye dhe personave të hequr pa bazë nga liria; aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan departamenti i përgjithshëm me shenjën C.nr.348/15 datë 02.05.2019, nr. të lëndës 2019:087533; aktgjykimin e gjykatës së Apelit me shenjën AC.nr.4834/19 (nr. lëndës 2019:087533), i datës 11.11.2022; aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës me shenjën Rev.nr.42/23 i datës 10.02.2023; aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë me shenjën AC.nr.5426/17 lëshuar me datë 04.11.2020; aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë me shenjën C.nr.3363/13 datë 14.07.2020; aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë me shenjën C.nr.2557/13 i datës 17.10.2019.

Gjykata pas vlerësimit të theksimeve të palëve dhe provave të administruara në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

### **Kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.**

Nga leximi i aktvendimit për fillimin e hetimeve me shenjën PP/I.nr.86/17, të datës 19.07.2017, gjykata vërtetoi faktin se Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, me datën 19.07.2017, kishte marrë aktvendim për fillimin e hetimeve ndaj këtu paditësit B.H. dhe E.B. për shkak të dyshimit të arsyeshëm se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1, lidhur me par.2, nën par.2.2, lidhur me nenin 31 të KP-së.

Nga leximi i aktakuzës me shenjën PP/I.nr.86/17, të datës 31.08.2017, gjykata vërtetoi faktin se Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, me datën 31.08.2017, kishte parashtruar Aktakuzë në gjykatën Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, ndaj

këtu paditësit B.H. për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1, lidhur me par.2, nën par.2.2 të KP-së.

Nga leximi i aktgjykimit me shenjën PKR.nr.89/17, të datës 26.02.2018, të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, gjykata vërtetoi faktin se paditësi B.H. konform nenit 364 par.1, pika 1.3 të KPP-së, është liruar nga akuza.

Nga leximi i aktgjykimi me shenjën PAKR.nr.223/18, të datës 06.09.2018, të lëshuar nga Gjykata e Apelit në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, është refuzuar si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, kurse është vërtetuar aktgjykimi me shenjën PKR:nr.89/17, i datës 26.02.2018.

Nga leximi i kërkesës së të autorizuarit të paditësit drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Komisionit për kompensimin e dëmit të personave të privuar pa bazë nga liria, të datës 27.07.2019, gjykata vërtetoi faktin se i autorizuari i paditësit i ishte drejtuar të paditurës së parë Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me seli në Prishtinë, lidhur me kërkesën për arritjen e marrëveshjes për kompensimin e dëmit për paditësin B.H. i cili me aktgjykim të formës së prerë është liruar nga akuza.

Nga leximi i aktvendimit me numër të protokollit 09/136, të datës 11.11.2019, lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Komisioni për kompensimin e dëmit të personave të dënues pa arsye dhe personave të hequr pa bazë nga liria, gjykata vërtetoi faktin se ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa e këtu paditësit B.H. nga Prizreni, për kompensimin e dëmit për shkak të zhvillimit të procedurës penale të pa arsyeshëm.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka bërë leximin e aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me shenjën C.nr.348/15, të datës 02.05.2019, me numër të lëndës 2019:087533; aktgjykimin e Gjykatës së Apelit me shenjën AC.nr.4834/19 (nr. lëndës 2019:087533), i datës 11.11.2022; aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës me shenjën Rev.nr.42/23 i datës 10.02.2023; aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë me shenjën AC.nr.5426/17, lëshuar me datë 04.11.2020; aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë me shenjën C.nr.3363/13 datë 14.07.2020; aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë me shenjën C.nr.2557/13, i datës 17.10.2019, mirëpo vlerësoj se të njëjtat janë pa ndikim në këtë çështje juridike kontestimore.

### 3. Baza Ligjore

Gjykata vlerëson se në këtë çështje kontestimore gjen zbatim Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve 04/L-007, i cili ka hyrë në fuqi me datë 20.12.2012.

Neni 136 i Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve (LMD), në par.1 të tij përcakton se: “*Kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë ta kompensoj, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij*”, neni 137 i po këtij ligji përcakton: “*Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material).*”, neni 140 i këtij ligji përcakton: “*Fajësia ekziston*

kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia”. Ndërsa neni 183 i LMD-së, ka përcaktuar se “Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëndtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material”.

#### 4. Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës

Duke marrë parasysh të gjitha pretendimet e palëve ndërgjyqëse, provat e administruara më lartë në lidhje me këtë çështje kontestimore dhe dispozitat e lartcekura ligjore, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar dhe se e njëjta duhet të refuzohet, sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ishte kontestuese mes palëve, se me aktvendimin PP/I nr.86/17, të datës 19.07.2017, kishin filluar hetimet ndaj këtu paditësit B.H. nga Prizreni, për shkak të dyshimit të kryerjes së veprës penale, ndërsa aktakuza ndaj të njëjtit ishte parashtruar me datë 31.08.2017. Po ashtu nuk ishte kontestuese se me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, me shenjë PKR.nr.89/17, të datës 26.02.2018, paditësi ishte liruar nga akuza, ndërsa me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit me shenjë PAKR.nr.223/18, të datës 06.09.2018, ishte vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda.

Gjykata, vlerëson se në këtë çështje kontestimore, baza juridike e kërkesëpadiës nuk gjen mbështetje në nenin 136 par.1 dhe 140 të LMD-së, për arsye se dëm konsiderohet vetëm dëmi i cili si i tillë pranohet nga e drejta. Kështu dëmi përfaqëson dëmtimin që pëson një person i caktuar në të mirën juridike që mund të jetë personale dhe pasurore, me kusht që ato të jenë juridikisht të mbrojtura. Nga vetë përmbajtja e nenit 136 par.1 të LMD-së, rezulton se ai që i shkakton dëm tjetrit ka për detyrim t’ia shpërblejë atë. Për të ekzistuar përgjegjësia për shpërblimin e dëmit është e nevojshme që të jetë shkaktuar dëmi, të dihet shkaktari i tij dhe të ekzistojnë parakushtet e përgjegjësisë për kompensimin e dëmit mbi bazën e fajësisë apo mbi ndonjë bazë tjetër ligjore. Për të ekzistuar detyrimi për kompensimin e dëmit duhet të plotësohen këto parakushte: a) të shkaktohet dëmi; b) që dëmi të jetë shkaktuar me veprimin/mosveprimin e kundërligjshëm; c) të ekzistojë faji i dëmtuesit; d) që të ekzistojë aftësia deliktore dhe e) të ekzistojë lidhja kauzale ndërmjet veprimit/mosveprimit të kundërligjshëm dhe dëmit. Në rastin konkret nuk janë plotësuar parakushtet ligjore për të ekzistuar përgjegjësia e të paditurve për kompensimin e dëmit këtu paditësit.

Përkatësisht me nenin 525 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (tutje: KPPRK), është përcaktuar se cilët personat kanë të drejtë kompensimi për gjykim të paarsyeshëm. Kështu në paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se: “Të drejtë në kompensim dëmi për dënim të paarsyeshëm ka personi kundër të cilit është shqiptuar sanksioni penal në formë të prerë ose që është shpallur fajtor dhe është liruar nga dënimi por që më vonë, sipas mjetit të jashtëzakonshëm

*juridik, procedura e rishikuar është pushuar në formë të prerë ose me aktgjykim të formës së prerë është liruar nga akuza ose akuza është refuzuar, përveç në këto raste: 1.1. kur pushimi i procedurës ose aktgjykimi me të cilin akuza është refuzuar ka ndodhur për arsye se në procedurën e re i dëmtuari është tërhequr nga propozimi si rezultat i marrëveshjes me të pandehurin; ose 1.2. kur në procedurën e rishikimit me aktvendim është refuzuar akuza për shkak të mos kompetencës së gjykatës, e paditësi i autorizuar e ka ndërmarrë ndjekjen në gjykatën kompetente”.*

Po ashtu me neni 529 të KPPRK-së, është përcaktuar se cilët personat që kanë të drejtë në kompensim për heqje lirie pa bazë. Paragrafi 1 i këtij neni përcakton se: *“E drejta në kompensim dëmi i takon gjithashtu: 1.1. personit i cili është mbajtur në paraburgim e kundër tij nuk është filluar procedurë penale ose procedura është pushuar me aktvendim të formës së prerë ose ai me aktgjykim të formës së prerë është liruar nga akuza apo akuza është refuzuar; 1.2. personit i cili ka mbajtur dënimin me heqje të lirisë dhe me rastin e rishikimit të procedurës penale ose kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë i është shqiptuar dënim me burgim më të shkurtër nga dënimi të cilin e ka mbajtur, apo i është shqiptuar sanksion penal pa heqje të lirisë ose është deklaruar fajtor dhe është liruar nga dënimi; 1.3. personit i cili për shkak të gabimit ose veprimit të paligjshëm të një organi është arrestuar pa arsye ose është mbajtur një kohë në paraburgim apo në një institucion korrektues për mbajtjen e dënimit ose masës së shqiptuar; dhe 1.4. personit i cili në paraburgim ka kaluar kohë më të gjatë se sa dënimi me burgim për të cilin është gjykuar”.*

Nga provat e administruara dhe të vlerësuara gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pathemeltë. Kjo për faktin se me asnjë provë nuk është vërtetuar se ndaj paditësit është shqiptuar sanksioni penal në formë të prerë ose është shpallur fajtor dhe është liruar nga dënimi por që më vonë, sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik, procedura e rishikuar është pushuar në formë të prerë ose me aktgjykim të formës së prerë është liruar nga akuza ose akuza është refuzuar dhe se i njëjti ka qëndruar në paraburgim apo arrest shtëpiak. Nga kjo rrjedhë se paditësi B.H. gjykatës nuk ka arritur ti provoj se i njëjti ka pësuar dëm nga ana e veprimeve të ndërmarra nga të paditurat. Në bazë të nenit 7 par. 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, është papaparë që *“palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”* ndërsa neni 319.1 parasheh që *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*. Kjo do të nënkuptonte se barra e të provuarit për realizimin e kërkesës për dëmshpërblim bie mbi paditësin. E në rastin konkret paditësi nuk ka arritur që të argumenton faktin se ndaj tij janë caktuar apo shqiptuar masat apo sanksionet me të cilat i është shkaktuar dëm jo material. Pra, paditësi nuk hynë në kategorinë e personave të cilët gëzojnë mbrojtje juridike civile sipas nenit 525 dhe 529 të Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata i ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të administruara në shqyrtimin kryesor, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen meritore të kësaj çështje juridike-kontestimore.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale gjykata e morri në bazë të nenit 450 dhe nenit 463 par.1 të LPK-së, pasi që të paditurat nuk i kanë kërkuar shpenzimet procedurale.

Nga të cekurat më lartë dhe bazuar në nenet 136, 137 dhe 140 të LMD-së, lidhur me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
**2019:291466, 15.08.2023**

**G j y q t a r i**

---

**Baki Shigjeqi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.